



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2434, datë 13.04.2014**

**Për**

**“Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Altelecom sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 13.03.2014, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Altelecom sh.a**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2120, date 04.07.2012 Per “Përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.2431, datë 13.03.2014 për “Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.2431, datë 13.03.2014 për “Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””
2. Projektvendim i KD të AKEP për “Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Altelecom sh.a
3. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*), si dhe,
4. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

## V Ë R E N:

1. AKEP në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar me Vendim nr.2118, datë 4.07.2012, dhe me Vendimin Nr.2120, datë 4.07.2012, ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të Eagle Mobile sh.a. (aktualisht Altelecom sh.a) deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër.
2. AKEP në dokumentin e Analizës së tregut celular të miratuar më 4.07.2012, në Seksionin III.3.IV, është shprehur midis të tjerave se:

*Per periudhen pas 2013 AKEP gjykon se aplikimi i modelit BULRAIC i paster dhe rekomandimit te KE do te ishte menyra me e mire per rregullimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare. Per te realizuar kete AKEP, do te ndertoje nje model te ri te paster BULRAIC ose do te perdore nivelin benchmark te vendeve qe e kane ndertuar keto modele per percaktimin e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare (sipas rekomandimit te KE), si dhe do te ndjeke te gjitha procedurat e konsultimit publik dhe njoftimit te paleve te interesuara per keto procedura.*

3. AKEP me Vendimin nr..2412, datë 16.01.2014 miratoi nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”. Periudha e këshillimit publik u zhvillua për një muaj më 16.01.2014-16.02.2014. Dokumenti “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*” I nxjerrë në këshillim public përmbante midis të tjerave:
  - një historik të ecurisë së nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet

celulare në Shqipëri;

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”,  
Godina Torre Drini, K. IX, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571  
Fax : ++ 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)  
[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

- tarifata mesatare në vendet e BE dhe rajonit (sipas publikimeve të KE dhe BEREC)
  - propozimin për rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit celular në Shqipëri, përfshirë për Albtelecom sh.a
4. Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komentet palët e interesuara përfshirë Albtelecom sh.a me shkresën Nr.1109 Prot, datë 14.02.2014.
  5. Me vendimin nr.2431, datë 13.03.2014, AKEP miratoi dokumentin final “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, si dhe qëndrimet ndaj komenteve të palëve të interesuara, përfshirë komentet e Albtelecom.
  6. AKEP në përcaktimin e nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të përcaktuar në dokumentin final “*Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, ka marrë në konsideratë
    - a. Rekomandimin e Komisionit Evropian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC)
    - b. Të dhënat e Komisionit Evropian të publikuara për Axhendën Dixhitale të BE
    - c. Të dhënat më të fundit të publikuara nga BEREC për tarifata e terminimit në rrjetet celulare
    - d. Të dhëna të publikuara nga Cullen International në lidhje me aplikimin e LRIC të pastër
    - e. Kushtet aktuale të tregut celular në Shqipëri
    - f. Aplikimin e reduktimit të përshkallëzuar të tarifave të Albtelecom
  7. AKEP vlerëson se rishikimi i nivelit të tarifave të shërbimit me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin e secilit operator celular me FNT, për orientimin në kosto LRIC të pastër, sipas rekomandimeve të KE, janë të rëndësishme dhe me interes për të gjithë tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Vlerat maksimale të tarifës për shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. të përcaktuar me FNT për këtë shërbim me VKD nr.2120 datë 4.07.2012, për t’u aplikuar nga

Albtelecom sh.a duke filluar nga data 1.04.2014 të jenë sipas vlerave dhe afateve të përcaktuara në tabelën e mëposhtëme:

	<b>1.04.2014</b>	<b>1.04.2015</b>	<b>1.01.2016-</b>
<b>Albtelecom (EM)</b>	4.00	2.66	1.48

*Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH*

2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Albtelecom sh.a dhe palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ për këtë vendim brenda 30 ditëve nga publikimi i këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE